Tabelat me poshte tregojne Objektivat Kornbetare te Cilesise se Ajrit per cdo ndotes, dhe limitet ose vlerat e synuara te Direktives Europiane ne perputhje me dy direktivat e BE: Direktiven 2008/50/EC mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe një ajër më të pastër në Evropë dhe Direktiven 2004/107/EC në lidhje me arsenikun, mërkurin, nikelin dhe hidrokarbureve aromatike polciklike në ajrin e mjedisit. Këto standarde dhe objektiva janë përmbledhur në tabelat e mëposhtme (Tabela 1, 2 dhe 3).

Tabela 1. Vlerat llimite te ndoteseve te ajrit bazuar ne shendetin human

Ndotesi	Pergendrimi	Periudha mesatare	Tejkalimet e lejuara cdo vit	Afati per tu arritur
Lenda Grimcore (PM2.5)	25 µg/m3 nga 2015			
	20 µg/m3 nga 2020			
PM10	50 µg/m3	24 ore	35	10 vite nga adoptimi i strategjise
	40 µg/m3	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
Diosksidi i Squfurit (SO2)	350 µg/m3	1 ore	24	5 vite nga adoptimi i strategjise
	125 µg/m3	24 ore	3	5 vite nga adoptimi i strategjise
Dioksid Azoti (NO2)	200 µg/m3	1 ore	18	10 vite nga adoptimi i strategjise
	40 µg/m3	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
Plumb (Pb)	0.5 µg/m3	1 vit	n/a	5 vite nga adoptimi i strategjise
				5 vite nga adoptimi i strategjise
Monoksid Karboni	10 mg/m3	Maksimumi nje mesatare ditore 8 oreshe	n/a	5 vite nga adoptimi i strategjise
Benzene	5 µg/m3	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise

Tabela 2. Vlerat e synuara (target) te ndoteseve te ajrit

Ndotesi	Pergendrimi	Periudha mesatare	Tejkalimet e lejuara cdo vit	Afati per tu arritur
Ozone	120 µg/m3	Maksimumi nje mesat. ditore 8 oreshe	25 dite ne vit me mesatare te marre mbi 3 vjet	10 vite nga adoptimi i strategjise
Arsenik (As)	6 ng/m3	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
Kadmium (Cd)	5 ng/m3	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
Nikel (Ni)	20 ng/m3	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
Hidrokarburet polciklike aromatike	1 ng/m3 (shprehur si perqendrim i Benzo(a)piren)	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise

Vendime të Këshillit të Ministrave:

V.K.M Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"

V.K.M Nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt të tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".

V.K.M Nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të Lejeve të mjedisit"

V.K.M Nr. 227, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave dhe të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore".

V.K.M Nr. 177, 06.03.2012, "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", i ndryshuar.

V.K.M Nr. 587, datë 7.07.2010 "Mbi monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbanë dhe turistike"

V.K.MNr. 994, datë 02.07.2008 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin"

V.K.M Nr. 853, datë 28.12.2005 "Për miratimin e listes së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera që ndalohen të importohen me qëllime ruajtje, depozitimi dhe asgjësimi"

V.K.M Nr. 248, datë 24.04.2003 "Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe zbatimin e tyre".

V.K.M Nr. 435, datë 12.09.2002 "Për Miratimin e Normave të Shkarkimeve në Ajër në Republikën e Shqipërisë"

V.K.M Nr. 103, datë 31.03.2002 "Mbi Monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë".

Udhëzime dhe Rregullore:

Udhëzim i Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Financave Nr. 7938, datë 17.7.2014 'Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së'

Udhëzim i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Nr. 8 date 27.11.2007 "Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara"

Gjithashtu, Shqipëria është palë e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi Biodiversitetin, Ndryshimet Klimatike, procesin e shkretëtizimit, Specie në rrezik, Mbetjet e dëmshme, Ligjin mbi detin, Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit dhe Lagunave.

Gjatë hartimit të këtij raporti VNM-je, janë marrë në konsideratë edhe disa nga Direktivat kryesore të BE-së për mjedisin:

- Direktiva 1999/30/CE date 22 Prill 1999, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit. (Council Directive 1999/30/EC of 22 April 1999 relating to limit values for sulphur dioxide, nitrogen dioxide and oxides of nitrogen, particulate matter and lead in ambient air)

- ✓ VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- ✓ VKM Nr. 641, datë 1.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte"
- ✓ VKM Nr. 117, datë 13.2.2013 "Për kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qenuri mbetje".
- ✓ VKM Nr. 177, datë 6 mars 2012 "Për paketimin dhe paketimin e mbetjeve".
- ✓ Urdhër Nr. 893, datë 4.10.2013 "Për miratimin e modelit të regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vajra të përdorura".

Amenduar nga:

- ✓ Ligj Nr. 32/2013 datë 14.2.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- ✓ Ligj Nr. 156/2013 datë 10.10.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar"

Këto udhëzime nenvijzojnë nevojën për zbatimin e një hierarkie të menaxhimit të mbetjeve që përfshin parandalimin, riciklimin/ ripërdorimin; trajtimin dhe asgjësimin. Udhëzimet kërkojnë ndarjen e mbeturinave konvencionale nga mbetjeve të rrezikshme dhe në qoftë se gjenerimi i mbeturinave të rrezikshme nuk mund të parandalohet (siç është rasti në objektet e kujdesit shëndetësor); menaxhimi i tij duhet të fokusohet në parandalimin e dëmit ndaj shëndetit, sigurisë dhe mjedisit, në përputhje me parimet e mëposhtme:

- ✓ Njohja dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme dhe rreziqeve që lidhen me menaxhimin e cdo lloj mbetje të rrezikshme të krijuar gjatë ciklit jetësor të saj të plotë.
- ✓ Sigurimi që njerëzit/firmat që merren me trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme janë ndërmarrje me reputacion dhe legjitime, të licencuara nga agjencitë përkatëse rregullatore dhe këto zbatojnë praktikën me të mira të industrisë.
- ✓ Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret e aplikueshme.

LEGJISLACIONI PËR PLANIFIKIMIN TERRITORIAL TRASHËGIMIN KULTURORE DHE GJETJET E RASTESISHME

Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" synon të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore si edhe të vlerësive potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e private. Ligji synon të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;

Ligji zbatohet nga:

- ☐ VKM Nr. 408, datë 13.5.2015. Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"
- ☐ VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit".

1. Zonat dhe itineraret e rruges që do të shmangen për shkak të ndjeshmërisë ose vlerës shumë të lartë të tyre (vlerave kulturore dhe natyrore të mbrojtura, pyjet me vlerë natyrore dhe tokës bujqësore, rezervave-ujore, etj.)
2. Masat lehtësuese që janë për të ulur, zbutur dhe/ose parandaluar ndikimet në mjedis. Për këtë, Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor paraqet një segment të rëndësishëm të dokumentacionit të plan-studimit dhe lejon një vlerësim gjithëpërfshirës të projektit të rruges. Qëllimi kryesor i Procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor është për të inkurajuar në futjen e aspekteve mjedisore në procesin e planifikimit dhe procesin e vendim-marrjes, duke synuar të rezultojmë aktivitete të pranueshme mjedisore.
3. Ligjet dhe rregullat aktuale mbi Mbrojtjen Mjedisore. Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor u përgatit në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes Mjedisore Nr. 8934, datë 5-9-2002 të Qeverisë së Shqipërisë dhe Direktivës së EIA Nr. 6, datë 27-12-2006 lidhur me Metodologjinë e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor të industrive dhe aktiviteteve të infrastrukturës, për të cilin vlerësimi i ndikimit mjedisor është i detyrueshëm dhe paisjet dhe objektet inxhinierike mund të ndërtohen dhe drejtohen vetëm kur ato kanë licencë mjedisore.

Ligji mbi Mjedisin është harmonizuar me rregullat Europiane dhe Internacionale që vijnë:

- Marrëveshja UNECE në Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor Përtej-Kufitare (1991, Espoo, Finlandë),
- Marrëveshja UNECE në të Drejtën për Informim, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendim-Marrje, po ashtu dhe të Drejtën mbi Legjislacionin për Çështjet Mjedisore (1998, Aarhus, Danimark),
- Udhëzimi IPPC 96/61/EC (IPPC - Parandalim i Njësuar dhe Kontrolli i Ndotjes), Udhëzimi - Seveso II (Parandalimi i Katastrofave në Shkallë të Gjërë).

Të gjitha ligjet e përmendura më lart janë adoptuar në relacionin aktual, si strukturë e ligjeve mjedisore. Ligjet janë zhvilluar mbrenda programit PHARE të Komisionit Europian dhe janë harmonizuar me rregullat Europiane. Ligjet gjithashtu janë imponuar edhe nga Ministria e Mjedisit dhe ajo e Turizmit.

Në përgatitjen e dokumentacionit të Vlerësimit të ndikimit mjedisor, standartet dhe praktikët e rekomanduara të publikuara nga Komisioni Ekonomik i Keshillit të Europës (UNECE, edicioni i tretë - Shkurt 2002) janë marrë në konsideratë, po ashtu dhe kërkesat e Institucioneve financiare Internacionale (WB, EBRD, EIB). Direktivat janë përgatitur në akordancë me normat dhe standartet e BE-së, dhe janë implementuar që më 1 Janar 2007. Çështjet mjedisore, brënda direktivave, janë shtjelluar imtësisht në librin "Rruga dhe Mjedisit".

Objektivat afatgjatë të VNM-së janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut.
- Parashikon dhe përjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe dëmtimet serioze të mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentët përbërës të ekosistemeve.
- Përmirëson aspektet sociale të projektit.

Në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë kërkohet: "mirëmbajtje e një mjedisi tepër të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm". Kjo por edhe opinionin e gjithë shoqërisë i shprehur nëpërmejt ligjeve të tjerë, detyron marrjen e masave immediate për rehabilitimin e mjedisit të degraduar gjatë epokës së industrializimit socialist dhe ruajtjen e tij nga aktivitetet e sotme prodhuese / ridertuese që gjithashtu shkaktojnë dëmtime të mjedisit. Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat europiane të mbrojtjes së tij ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët.

Ligji i parë për mbrojtjen mjedisore daton në vitin 1993 dhe shprehet se: "të gjitha veprimtaritë e personave fizike dhe ligjore, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të nënshtrohen vlersimeve mjedisore" Më tej, Ligji Nr. 8934, mbi mbrojtjen mjedisore përcakton se: "Mbrojtja e mjedisit është detyrim i të gjithë shtetasve dhe individëve me veprimtari në Shqipëri"

Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim - marrëse për liqensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

Parimet e mbrojtjes së mjedisit.

- Parimi i zhvillimit të qendrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

1.7. PËRSHKRIMI I MJEDISIT AKTUAL

1.7.1. Qëllimi i vlerësimit të ndikimit mjedisor (VNM)

Në lidhje me ndikimet e mundëshme direkte dhe indirekte, si edhe mundësia e vlerësimit të një ndikimi negativ potencial nga ndërtimi i godinave të banimit.

1.7.2. Struktura morfologjik dhe gjeologjik

Faza 1: Puna paraprake:

Një studim gjithëpërfshirës i gjithë dokumentacionit ekzistues është kryer, duke përfshirë edhe literaturën që ka lidhje me gjeologjinë, gjeologjinë inxhinierike, hidrogjeologjinë, gjeoteknikën dhe rishikimin e hartave gjeologjike ekzistuese në mënyrë që të krijohet një bazë për studime shtesë në terren (faza 2).

Qëllimi dhe objektivat e kryerjes së këtyre punimeve kanë qënë :

"PARKIM MAKINASH DHE MJETESH TE RENDA", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË, ME ZHVILLUES SHOQËRINË "SOLEIL & SEA" SH.P.K

Duke u nisur nga qëllimi dhe detyrat e këtij studimi, pra për studimin e kushteve gjeologjiko-ingjnierike në lidhje me qëndrueshmërinë e trullit ku do të ndërtohet janë përdorur kriteret e mëposhtme:

- Kriteri i kushteve gjeomorfologjike
- Kriteri i kushteve hidrogjeologjike
- Kriteri i vetive fiziko mekanike të dherave
- Kriteri i fenomeneve gjeodinamika

Në bazë të kriterit të kushteve gjeomorfologjike zona është përfshirë në një njesi morfologjike:

- Njësi morfologjike fushore

Sipas kriterit të kushteve hidrogjeologjike, zona e studiuar ndahet sipas komplekseve ujëmbajtëse.

Ndërsa në bazë të kriterit të vetive fiziko mekanike të dherave dhe shkëmbinjve zona e studiuar është ndarë në:

- Dhera pa kohezion
- Dhera me kohezion

Gjithashtu sipas kriterit të fenomeneve gjeodinamike, studimi do të përmbajë dhe dukuritë gjeodinamike si erozioni dhe neotektonika etj., që do të përbejnë zona me rrezikshmëri gjeologjike.

• PASURITË KULTURORE

Në të gjithë zonën takohen mjaft monumente të trashëgimisë kulturore të vendit si kështjella, kisha e manastire. E rrethuar me shumë pika turistike arkeologjike si; Kalaja e Gjon Boçarit, Kalaja e Kaninës, Parku Arkeologjik i Orikumit, Kisha e Marmiroit, Tragjasi i vjetër, Baza ushtarake Pashalimanit, Laguna e Pashalimanit etj dhe shumë plazhe e gjire të paeksploruara si; Gjiri i Dafinës, Gjiri i Skalomës, Gjiri i Brisanit, Kanioni i Skafistëve, Shpella e Haxhi Alisë, Gjiri i Inglezit etj, e kthen zonën në një mini qendër me funksione dhe shërbime të nevojshme. Vendndodhja në kryqëzimin e rrugëve që të shpërndajnë në Jug të vendit e kthen kompleksin në një vendndalim dhe nukël të rëndësishëm në zonën e Orikumit.

• KLIMA

Zona e projektit ndodhet në zonën e ulët mesdhetare të Mesdheut, e cila mbulon pothuajse të gjitha ultësirën bregdetare të Shqipërisë. Kjo klimë mesdhetare karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë, dhe dimrat e ftohtë dhe të lagësht. Mesatarja vjetore e reshjeve është midis 950 - 1200 mm / yr, ku pjesa më e madhe e shiut bie gjatë tetorit-marsit (70-80%). Temperatura mesatare vjetore matet midis 15 ° -18 ° C. Temperaturat më të larta maten gjatë periudhës qershor-gusht, me një maksimum prej 30 ° -35 ° C. Temperaturat më të ulëta të regjistruara në muajin janar, duke arritur vlerat mes 6.5 ° -7.5 ° C.

Faktorët që përcaktojnë klimën në këtë fushë janë: a) Pozita gjeografike (afërsia me detin); b) Ndikimi i cikloneve dhe anti-cikloneve që rregullojnë atë, dhe c) Morfologjinë e rajonit

Regjimi i reshjeve atmosferike për zonën në studim është tipik i karakterit mesdhetar me maksimum në periudhën e dimrit dhe minimum gjatë periudhës së verës. Karakteristikë tjetër për regjimin e reshjeve në zonë është edhe intensiteti i madh i tyre. Sasitë deri në 100 mm për 24 orë janë dukuri e zakonshme, ndërkohë që ka raste që bien 300 mm e më shumë për të njëjtin interval kohe. Sasitë më të mëdha 24 orëshe vërehen në periudhën e vjeshtës për shkak të aktivitetit ciklonik në këtë periudhë.

• GJEOLGJIA DHE TOKAT

Zona e propozuar për ndërtimin e vilave gjendet në zonën Sazani, e cila përfaqëson njësinë më perendimore të Albanideve të Jashtme, një brez i rrudhosur e mbulesor, që mbulon pothuajse gjysmën e Shqipërisë.

Zona ndërtohet nga depozitime që datojnë nga jurasiku e deri në kuaternar. Nga pikpamja litologjike zona e propozuar për zhvillimin e projektit ndërtohet kryesisht nga formacione gëlqerore e terrigjene dhe më pak depozitime eluvialo-deluviale.

Formacionet gëlqerore, të cilat përfaqësojnë edhe formacionin rrënjësor të zonës në studim, paraqiten masivë me ngjyrë të bardhë dhe gri dhe kanë aftësi të mira ujëmbajtëse. Kufiri ndërmjet tyre dhe formacionit flishor është në nivelin e rrugës automobilistike.

Formacionet terrigjene, ndërtohen nga depozitime flishore të ndërthurjes argjilo-alevrolito-ranore, ritëm mesëm deri ritëm trashë. Elementët e shtresëzimit janë me shtrirje 320 - 330° dhe rënie 30 - 35° në juglindje. Shpesh për shkak të rrudhosjeve këta elementë ndryshojnë nga njëri sektor në tjetrin. Formacioni rrënjësor nuk del gjithnjë në sipërfaqe.

përfaqësohen gati krejtësisht nga burime karstike të llojeve të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre burimeve shfaqen në buzë të detit (burime bregdetare) ose nën det (burime nëndetare). Kjo lidhet me faktin që malet në këtë pjesë bien drejtpërdrejt mbi det, kështu që niveli bazë i ujërave nëntokësorë është deti. Burimet kryesore këtu dalin ose në vijën bregdetare duke u përzier me ujin e detit dhe për këtë arsye janë të kripura. Burime të mirëfillta karstike këtu ka shumë pak dhe shfaqen në pjesët e larta të maleve ose diçka më poshtë.

1.8. PËRSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

Projekti objekt i këtij raporti të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis ndodhet në Bashkinë Himare, Zona Kadastrale Nr. 3844, prone me numer pasurie 2/78. Siperfaqja e përgjithshme e truallit është $S = 50\,000\text{ m}^2$ dhe koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndertim është 0%. Prona ka komunikim të drejtpërdrejtë me rrugën. Në momentin e hartimit të këtij raporti të VNM- se në pronën, mbi të cilin do të ndertohet parkingu, u identifikua bimesi e katit të mesëm (bimesi shkurre), të cilat do të preket nga ndertimi. Persa i perket mbuleses bimore të sipërfaqes së shpatit malor të bregdetit të detit Jon, mund të themi se kjo zonë karakterizohet nga bimesia e katit të mesëm ku dominon brezi me bimesi shkurre. Shkurretat e zonës janë tipike të bimesisë mesdhetare të zonave bregdetare. Zona në vlerësim njihet për bimesi të pasur, por në truallin ku do ndertohet, bimesia që preket nga ndertimi është e varfër, kryesisht bimesi e katit të mesëm. Kjo zonë është e pasur persë i perket burimeve ujore sipërfaqesore të tilla si Det, Liqen, lumenj, perrenj, apo burime të vogla. Kur flasim për bimesinë shkurre, është e kuptueshme se ajo është gjithmone e shoqërueshme me bimesinë barishtore. Ndërsa persë i perket bimesisë së lartë, ajo gjendet në zonë të vecanta dhe haset rrallë. Relievi është i sheshtë për të vazhduar me tej me tip kodrinor-paramalor. Tokat kanë një përzierje kryesisht shkembore me përzierje gëlqerorësh.

Biodiversiteti

(Referuar Raportit të gjendjes së mjedisit për vitin 2019, Agjencia Kombëtare e Mjedisit).

Shqipëria është e njohur për shumëllojshmërinë e saj të lartë të burimeve gjenetike, specieve dhe ekosistemeve. Njihet gjithashtu si një vatër e rëndësishme biodiversiteti në Evropë me një diversitet të lartë ekosistemesh dhe habitatesh si dhe me një numër të madh llojesh sub-endemike, endemike, të ralla dhe të rrezikuara globalisht prezente në territor. Brenda territorit të saj gjenden ekosisteme detare, zona bregdetare, liqene, lumenj, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje gjethëgjërë dhe pyje halorë, kullota alpine e subalpine dhe llvadge, si dhe ekosisteme të larta malore. Ky diversitet i atribuohet pozicionit gjeografik të vendit si edhe karakteristikave të relievit, tokës, klimatike, hidrologjike dhe gjeologjike. Terreni malor i kombinuar me shkëmbinj të thepisur ka krijuar kushte ideale për mirembajtjen dhe mbrojtjen e një sërë specimesh relikte, disa prej të cilave endemike ose sub-endemike. Gjendja e biodiversitetit prezantohet me të dhënat e monitorimit të llojeve bimore e shtazore dhe rritjen e

dëmtshme të natyralizuara, 11 lloje të mbetura si ish kultura bujqësore, 9 lloje relikte si dhe 38 lloje që përbëjnë lloje të reja të zbuluara, nga ku 41 lloje të introduktuara për të të cilat supozohej dhe ishin rregjistruar si të zhdukura.

Lidhur me florën detare janë rregjistruar 186 lloje. Për më tepër, lista e bimëve të kërcënuara në nivel kombëtar është goxha e gjatë, dhe përfshin 319 lloje, 76 prej të cilave janë në një rrezik të vazhdueshmë, 123 të rrezikuara ndërsa 120 lloje të tjera në përkeqësim, që të gjitha të marra sëbashku përballen me një rrezik të lartë në nivel kombëtar. Në Shqipëri egzistojnë rreth 32 lloje bimësh endemike dhe përafërsisht 110 lloje sub-endemike, habitat i të cilave ndahet ndërmjet Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë dhe Greqisë.


Moratoriumi i gjuetisë i vendosur me ligjin Nr. 7/2014 "Per ndalimin e gjuetisë në Republikën e Shqipërisë" deri në vitin 2016 dhe i shtyre për një periudhë të dytë deri në vitin 2021 ka bërë të mundur shtimin e numurit të një sere specimesh të faunës së eger, kryesisht 59 llojet që kanë qenë objekt gjuetie. Vitin e fundit të dhenat e sondazheve dhe monitorimit vitin e kaluar tregojnë:

- Praninë e zogjve shtegtarë në afërsi të bregdetit, gjë që tregon se ekziston paqe dhe është eliminuar në një masë të madhe gjuetia e paligjshme kushtëzuar afërimit të tufave të këtyre specieve në bregdet;
- Praninë e disa specieve si shqiponja e ndotur e Madhe (*Aquila clanga*, *Clanga c.*) në Divjakë, ose pelikani kacurrell (*Pelecanus sp.*) në Velipojë, specie që nuk ishin raportuar për vite në këto zona;
- Prania e shumtë e specieve të shpendëve shtegtarë është shtuar si rezultat i vendosjes në ligatinat në zbatim të moratoriumit të gjuetisë - ky konstatim tashmë është verifikuar nga kryerja e dy regjistrimeve të specieve migratore të dimrit në shkurt 2016 dhe janar 2017;
- Përveç zogjve shtegtarë, llojet e tjera të faunës së egër siç janë gjitarët e mëdhenj kanë një prirje në rritje të pranishmësi së tyre të konfirmuar nga prania e tyre në kamerat e bllokimit të vendosura për të identifikuar speciet e rralla të kërcënuara, siç janë rrezet ose vëzhgimet, shoqata të specializuara mjedisore në kuadrin e donatorëve projekte të financuara. Regjistrimi Ndërkombëtar i Rendit të Zogjve (IĒC) është një program ndërkombëtar që ka filluar në Shqipëri që nga viti 1993 (me një numër të kufi zuar të ekspertëve dhe fushave kryesore në studim). Në tre vitet e fundit, 2016, 2017 dhe 2018, Regjistrimi u krye me mbështetjen e Projektit Natyror (Programi IPA I BE) dhe me pjesëmarrjen e OJQ-ve dhe ekspertëve të fushës dhe stafit të AKZM-se. Nga të dhenat e grumbulluara rezulton se numuri i zogjve në vitin 2019 është rreth 50% më i lartë se në vitin 2016.



Vendi ynë ka nivel të ulët të emetimit të karbonit nga industritë, trafiku, dhe burimet e tjera nderkohe që mbulesa e tokës mbizotërohet nga vegjetacioni duke na radhitur ndër vendet me nivel të lartë të sekuestrimit të karbonit nga ekosistemi natyror. Bregdeti Adriatik i Shqipërisë ka një potencial të mirë për mbrojtje nga rreziku i erozionit; kjo zonë kombinon një nivel të lartë të mbrojtjes nga erozioni me një ndjeshmëri të lartë për erozionin për shkak të shpateve, tokave të ndjeshme dhe reshjeve erozive të kombinuara me përdorimin intensiv të tokës nga njerëzit (Schulp et al., 2012). Në mënyrë të ngjashme, zonat bregdetare, ligatinat dhe përmbytjet paraqesin një mundësi të mirë për mbrojtje nga përmbytjet përgjatë vijës bregdetare të Shqipërisë dhe lumenjve të shumtë.

HARTA GJEOLIGJIKE E SHQIPERISE

SHKALLA 1 : 200000
VITI 1972



Harta gjeologjike e Shqipërisë






MINISTERO DELL'INTERNO
DIREZIONE GENERALE
UFFICIO CENTRALE

PROVINCIA DI ...
UFFICIO PROVINCIALE

UFFICIO REGIONALE

PROVINCIA DI ...
UFFICIO PROVINCIALE



- Legenda**
- ▬ Confine Regionale
 - ▬ Confine Provinciale
 - ▬ Confine Municipale
 - ▬ Confine Comunitario
 - ▬ Confine di Circondario
 - ▬ Confine di Comune
 - ▬ Confine di Frazione
 - ▬ Confine di Località
 - ▬ Confine di Contrada
 - ▬ Confine di Borgo
 - ▬ Confine di Villaggio
 - ▬ Confine di Fattoria
 - ▬ Confine di Casale
 - ▬ Confine di Locanda
 - ▬ Confine di Osteria
 - ▬ Confine di Taverna
 - ▬ Confine di Albergo
 - ▬ Confine di Hotel
 - ▬ Confine di Pensione
 - ▬ Confine di Casa
 - ▬ Confine di Appartamento
 - ▬ Confine di Stanza
 - ▬ Confine di Camera
 - ▬ Confine di Sala
 - ▬ Confine di Cucina
 - ▬ Confine di Bagno
 - ▬ Confine di Corridoio
 - ▬ Confine di Soggiorno
 - ▬ Confine di Sala da pranzo
 - ▬ Confine di Sala da tè
 - ▬ Confine di Sala da studio
 - ▬ Confine di Sala da gioco
 - ▬ Confine di Sala da lettura
 - ▬ Confine di Sala da scrittura
 - ▬ Confine di Sala da disegno
 - ▬ Confine di Sala da musica
 - ▬ Confine di Sala da danza
 - ▬ Confine di Sala da teatro
 - ▬ Confine di Sala da cinema
 - ▬ Confine di Sala da sport
 - ▬ Confine di Sala da palestra
 - ▬ Confine di Sala da piscina
 - ▬ Confine di Sala da giardino
 - ▬ Confine di Sala da terrazza
 - ▬ Confine di Sala da veranda
 - ▬ Confine di Sala da loggia
 - ▬ Confine di Sala da balcone
 - ▬ Confine di Sala da giardino
 - ▬ Confine di Sala da terrazza
 - ▬ Confine di Sala da veranda
 - ▬ Confine di Sala da loggia
 - ▬ Confine di Sala da balcone


1.9. PERSHKRIM I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET PROJEKTI


Projekti objekt i ketij raporti te vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ndodhet ne **Bashkine Himare**. Objekti qe kerkohet te merret me qera ndodhet ne njesine strukturore HI.N.755, ne te cilen nuk ndodhen objekte te cilat preken nga ndertimi.

Qellimi i kerkeses per marrje me qera te prones eshte ndertimi i nje hapesire parkimi, e cila do jete ne funksion te objekteve rezidenciale dhe hotelerive ne Jale dhe mjeteve te renda. Ne momentin e hartimit te ketij raporti te VNM-je ne pronen mbi te cilen do te ndertohet objekti, u identifikuan disa peme, te cilat do te preken nga ndertimi.

Zona ne vleresim njihet per bimesi te varfer dhe reliev te pjerret.

Fig: Foto te bimesise ne pronen ku do te ndertohet objekti





1.10. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE SAJ

Në zonën e zbatimit të këtij projekti, i cili propozohet të zhvillohet në zonë bregdetare dhe pranë një burimi ujqor të rëndësishëm të kësaj zone siç është Deti Jon ka burime ujqore, por jo në sipërfaqen e propozuar, ato ndodhen në një distancë, të tillë që ndikimet e këtij projekti nuk arrijnë efektet e tyre në këto burime ujqore. Burimi ujqor më i rëndësishëm, Deti Jon, i cili ndodhet ndodhet në Jugperëndim, mbi 80 m në vijë ajrore larg nga kufiri i pronës, e cila do të zhvillohet me ndërtim. Kjo distancë përbën edhe pikën më të afërt me objektin e ri. Sipas informacioneve të paraqitura nga subjekti zhvillues, ujërat e përdorura të objektit nuk do të shkarkohen në mjedisin e zonës, por do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve.

Bazuar në Ligjin Nr. 10234, datë 18.02.2010 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për menaxhimin e Intergruar të zonës bregdetare në Mesdhe" të Konventës së Barcelonës "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut", Pjesa II, neni 8, pikë 2.a), ndalohe ndërtimi i objekteve në një distancë më të afërt se 100 m vijë e gjerë bregdetare, e cila njihet si zonë sigurie, e cila mund të preket në mënyrë direkte apo indirekte nga ndryshimet klimaterike ose rreziqet natyrore. Bazuar në

të ujrave të Jonit. Habitate të rëndësishme për peshqit konsiderohen edhe livadhet e *Posidonia* sp. në thellësitë e 4- 5 m. Këto livadhe janë tepër të rëndësishme për ushqimin e strehimit të një numri të madh llojesh, përfshi peshqit, krustacet dhe invertebrorë. Faza e supralitoralit evidentohet nga prezenca e *Cyanobacteria* ku zhvillohen *Littorina*. Kjo fazë shtrihet vertikalisht deri në thellësinë nën 1 m në zonat e qeta. Në aspektin fizik të bregdetit jugor shkëmbor karakteristike janë llojet e *Cyanophyceae* sp., *Gastropods Littorina* sp. dhe *Cirripeds Chthamalus depressus*. Zona e mediolitoralit përfaqësohet nga cilësia e ujrave dhe prezenca e *Coralligenous algae* të përbëra nga *Lithophyllum* sp. që shtrihen përtej thellësisë vertikale më shumë se 1 m. Zona e infralitoralit shtrihet lokalisht në zonën e mbi 45 m thellësi. Infralitoralit përbëhet kryesisht nga *Cystoseira* sp. me *Padina* sp., *Acetabularia* sp., *Cymadocea* sp. mbi të cilat ushqehen lloje peshkore si *Sarpa salpa* etj.

Biocenoza më e rëndësishme në këtë zonë është bari i detit *Posidonia oceanica*, prodhimtaria primare e të cilit vlerësohet 21 t të lëndës së thatë/ha/vit. Livadhet e *Posidonia oceanica* janë vlerësuar si indikatorë të cilësisë dhe shëndetit të mirë të ujrave të detit dhe përdoren si indikatorë të monitorimit. Banorë të tjerë të kësaj zone janë ekinodermatet dhe krustacet e dekapodet.

Bashkia Himarë, e vendosur në bregun jugor të Shqipërisë, ofron një nga vijat bregdetare më spektakolare të vendit, me plazhe të shumta që dallohen për ujin e kristaltë, rërën e pastër dhe peizazhet mahnitëse. E rrethuar nga Deti Jon dhe male të larta, kjo zonë është një destinacion ideal për turizmin bregdetar dhe pushime relaksuese.

1. Plazhi i Livadhit

Plazhi i Livadhit ndodhet rreth 2 km larg qendrës së Himarës dhe është një nga plazhet më të mëdha dhe më të vizituara të zonës. Ai karakterizohet nga rëra e bardhë dhe guralecët e vegjël, si dhe ujërat e pastër blu të Jonit. Plazhi ofron hapësira të mëdha për relaksim dhe aktivitete ujore si kajak, paddleboard dhe zhytje. Përgjatë bregut ndodhen bare dhe restorante që ofrojnë ushqime tradicionale dhe pjë freskuese.

2. Plazhi i Potamit

I pozicionuar pranë qendrës së Himarës, ky plazh ka një kombinim unik të guralecëve të vegjël dhe rërës së butë. Ujërat e tij janë të thella dhe të pastër, duke e bërë atë një zgjedhje ideale për notarët me përvojë. Plazhi i Potamit është rrethuar nga shkëmbinj dhe pemë të gjelbra, duke ofruar një pamje natyrore mbresëlënëse dhe një atmosferë relaksuese.

3. Plazhi i Lllamanit

Një nga plazhet më piktoreske të zonës, Plazhi i Lllamanit, ndodhet disa kilometra larg qendrës së Himarës dhe është i arritshëm me makinë ose varka të vogla. Ky plazh ka ujë të kristaltë dhe është i rrethuar nga shkëmbinj të lartë që krijojnë një peizazh të veçantë. Plazhi është një destinacion i preferuar për snorkeling dhe eksplorimin e botës nënujore.

4. Plazhi i Jalit

I njohur për rërën e imët dhe ujërat e qetë, Plazhi i Jalesë është një nga më të bukurit në jug të Shqipërisë. Ai është shumë i preferuar nga të rinjtë dhe frekuentohet për kamping, muzikë live dhe festa verore. Plazhi ka një infrastrukturë të mirë të zhvilluar me resorte, bare plazhi dhe mundësi për sporte ujore si skijimi në ujë dhe kajak.

5. Plazhi i Gjipe-së

LLOJI I NDIKIMEVE TE IDENTIFIKUARA (DIREKTE DHE INDIREKTE)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore
- Parimi i zevendesimit dhe ose kompensimit
- Parimi i qasjes se integruar
- Parimi i pergjegjesise se ndersjellte dhe bashkepunimit
- Parimi Ndotesi paguan
- Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
- Parimi i nxitjes se veprimtareive per mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr.10440 date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe kerkesave te VKM Nr.686, date 29.07.2015 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtjen e mjedisit kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga demtimi. Kjo perben perparesi kombetare dhe eshte e detyrueshme per cdo banor te Republikes se Shqiperise, per te gjitha organet shteterore si dhe per personat fizike e juridike, vendas e te huaj, qe ushtrojne veprimtarine e tyre ne territorin e republikes se shqiperise.

Objektivat e mbrojtjes se mjedisit jane:

- a) Parandalimi kontrolli dhe ulja e ndotjes se ajrit, ujit, tokes dhe ndotjeve te tjera
- b) Ruajtja mbrojtja dhe permiresimi i natyres dhe biodiversitetit
- c) Ruajtja mbrojtja dhe permiresimi i qendrueshmerise mjedisore me pjesemarrje publike
- d) Perdorimi i matur dhe racional i natyres dhe burimeve te saj
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike te paisazhit natyror
- f) Mbrojtja dhe permiresimi i kushteve te mjedisit
- g) Mbrojtja dhe permiresimi i cilesise se jetes dhe shendetit te njeriut

NDIKIME TE RENDESISHME GJATE NDERTIMIT

1. SHKARKIMET NE UJE

Nga punimet ndertimore te ketij objekti nuk kemi ndotje te ujrave nentokesore. Ujrat qe dalin nga aktiviteti i ndertimit te objektit jane ujra te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lagies se kantierit, larjes se gomave te automjeteve dhe ujrat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Gjate ndertimit ne varesi te rreshjeve te shiut mund te grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujrave dhe si rrjedhoje mund te jete i nevojshem grumbullimi i ketyre ujrave dhe orientimi i tyre ne grope septike dhe me pas do te lidhen me sistemin e kanalizimeve te zones, pjeserisht ato filtrojne nentoke, pjesa me e madhe e tyre duhet te terhiqen me elektropompe dhe te shkarkohen ne gropen septike. Kjo deri ne daljen e objektit ne siperfaqe dhe rehabilitimin e shesheve te llra. Si rrjedhoje, punimet e ndertimit nuk duhet te tejzgjaten dhe te kalojne afatet e percaktuara ne lejen e ndertimit. Nuk

5. NDIKIMI NE BIODIVERSITET

Ky ndertim nuk prek zonat me biodiversitet. Menjeherë pas daljes nga themelet, subjekti duhet të kryejë rehabilitimin e mjedisëve përreth objektit dhe në përfundim të ndertimit të kryejë rehabilitimin e plote.

6. NDIKIME SOCIAL EKONOMIKE DHE MJEDISORE

